

A K T T H E M E L I M I

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"LULI FARMA " SH.P.K.



Ne Tirane, sot me 20. Mars 1996 z. Behar Shehu dhe Saimir Tahiri, banues ne Tirane me adresat e tyre perkatese, madhore me zotesi te plote juridike per te vepruar deklarojne ne kete akt themelimi si me poshte vijon:

Neni 1

Ortakët themeluesë z. Behar Shehu dhe Saimir Tahiri vendosin për krijimin e shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar të emërtuar "Luli-Farma" sh.p.k.

Neni 2

Kjo shoqëri me përgjegjësi të kufizuar është person juridik në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi dhe aktiviteti i saj rregullohet sipas dispozitave dhe statutit të kësaj shoqërie dhe duke u bazuar edhe në këtë akt themelimi si dy a baze të kësaj shoqërie.

Neni 3

Qendra e kësaj shoqërie do të jetë në qytetin e Tiranës me adresën e saj Rr. "Asim Vokshi", nr.64, me të drejtë për të ndryshuar qendrën e saj, si dhe për hapur degë dhe filiale të tjera në të gjithë Republikën e Shqipërisë si dhe jashtë në përputhje me legjislacionin shqiptar.

Neni 4

Kapitali fillestar i kësaj shoqërie do të jetë i përbërë nga një shumë prej 100.000 Lekesh, i cili përben kontributin e përbashkët të themeluesave të kësaj shoqërie, secili në masën 50%. Në këtë mënyrë do të jetë edhe ndarja e fitimit të realizuar gjatë aktivitetit të kësaj shoqërie.

Neni 5

Kohe zgjatja e kësaj shoqërie do të jetë në një afat kohë mbi 10 vjet. Për e cila mund të shpërbehet edhe me parë sipas rasteve të parashikuara në këtë statut (shpërberja dhe likuidimi).

Neni 6

Objekti i aktivitetit të kësaj shoqërie është përcaktuar me hollësi në nenin 4 të statutit të kësaj shoqërie. Kështu konkretisht kjo shoqëri do të ushtroje aktivitetin e saj në fushën e: Eksport-import dhe tregti me shumicë e pakicë të artikujve farmaceutikë, materialeve të mjekimit, higjieno-kozmetike, disinfektant, aparateve mjekësore, ushqimet për fëmijë, materialeve ortopedike, etj.

Neni 7

Fillimin e aktivitetit te saj tregtar kjo shoqeri e lidh me rregjistrimin e saj ne regjistrin tregtar te Gjykates se rrethit Tirane si dhe me pajisjen me licence nga Zyra e Tatimeve Tirane.

Neni 8

Aktiviteti ekonomik dhe investimet e kesaj shoqerie mbrohen nga legjislacioni shqiptar ne fuqi.

Neni 9

Administratore te pergjithshem te kesaj shoqerie do te jene z. Behar Shehu dhe Saimir Tahiri, i cili ushtron dhe ndjek aktivitetin e shoqerise te krijuar prej tyre duke zbatuar edhe kompetencat perkatese sipas dispozites perkatese te statutit.

Neni 10

Per ruajtjen dhe sigurimin e pasurive te luajtshem dhe te paluajtshem kjo shoqeri mund t'i drejtohet INSIG-ut ne qender dhe ne degjet e saj.

Neni 11

Dispozita me te hollesishme jane parashtruar dhe parashikuar ne statutin e kesaj shoqerie e cila shpreh vullnetin e lire te shemaluesave.


SHOQERIA NE PERQJECJESI TE KUPIZUAR

"LUMI-PARLU" SH.P.K.

BEHAR SHEHU



SAIMIR TAHIRI



Tirane, 26.03.1996

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA TIRANE

Nr. 1622 Rep.

Nr. 258 Kol.

VERTETIM

Sot me daten 26. 03. 1996 para noteres u paraqiten personalisht Behar Shehu dhe Saimir Takiri me leternjoftimet e tyre personale, madhor, me zotesi te pl juridike per te vepruar, te cilet deklaruan se sa me siper eshte sipas vullnetit te tyre te lire dhe te plote dhe e nenshkruajme ate rregullisht dhe une noterja e verte sipas ligjit.

NOTERE
NEXHLA KELLEZI

Kellezi



S T A T U T

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"LULI-FARMA" SH.P.K.



Ne mbeshtetje te ligjit 7638 date 19.11.1992, une Behar Shehu dhe Saimir Tahiri si ortakë te kesaj shoqërie me pergjegjesi te kufizuar "Luli-Farma" sh.p.k. me zotesi te plote juridike per te vepruar, deklarojme si me poshte vijon:

I. FORMIMI I SHOQERISE "LULI-FARMA" SH.P.K.

NENI 1

Formohet shoqëria me pergjegjesi te kufizuar e quajtur "Luli-Farma", me ortakë te saj themelues z. Behar Shehu dhe Saimir Tahiri, banues ne qytetin e Tiranes me adresat perkatese.

II. QENDRA E SHOQERISE "LULI-FARMA" SH.P.K.

NENI 2

Qendra e shoqërise "Luli-Farma" sh.p.k. do te jete ne qytetin e Tiranes me adrese Rr. "Asim Vokshi" nr. 84, Tirane. Kjo shoqëri mund ta ndryshoje adresen e saj sipas nevojave te saj, ose edhe mund te hapë vendqendrimë te tjera, ne qytete te tjera te Republikës se Shqipërisë, gjithnje ne zbatim te legjisllacionit shqiptar ne fuqi, edhe dispozitave te ketij statuti.

III. KOHEZGJATJA E SHOQERISE "LULI-FARMA" SH.P.K.

NENI 3

Kohezgjatja e aktivitetit te kesaj shoqërie do te jete per nje periudhe kohe e 10 vjet. Por ajo mund te shpërbehet ne çdo kohe gjithnje me vendim te ortakëve themelues si edhe te organit te saj vendimor.

IV. OBJEKTI I AKTIVITETIT TE KESAJ SHOQERIE

NENI 4

Objekti i aktivitetit te kesaj shoqërie do te jete: ne fushen e eksport-impord dhe tregti me shumice e pakice te artikujve farmaceutike, materialeve te mjekimit, higjiëno-kozmetike, dizinfektante, aparateve mjekesore, ushqimet per femije, materiale ortopedike, etj. Kjo shoqëri do te ushtroje aktivitetin edhe çdo aktivitet tjeter qe veças ose se bashku me ato te peramendura me sipër do te konsiderohen te pershtatshme per aktivitetin e kesaj shoqërie.

Behar Shehu
Saimir Tahiri

[Signature]
1992

V. KAPITALI FILLESTAR I "LULI-FARMA" SH.P.K.

NENI 5

Kapitali fillestar i kesaj shoqerie do te perbehet prej 100.000 leke, kapitali cili i perbehet nga kontributi i perbashket i te dy ortakeve te saj themeluese, kontribut ky i cili eshte ne masen 50 % per secilin ortak, dhe sipas kesaj menyre te futjes kontributit, do te behet edhe ndarja e te ardhurave te realizuara gjate aktivitetit. Kjo shoqeri me vendim te saj, te organit te saj vendimor mund te shtoje kapitalin e saj apo te pakesoje, duke shtuar investime te reja, duke i regjistruar keto pjesemarrje ne baze te legjislacionit shqiptar, po keshtu ajo ka te drejte edhe te transferoje kapitalin e saj interesave te shoqerise se krijuar. Kapitali fillestar i secilit ortak eshte i trashgueshem dhe pjeserisht apo plotesisht i transferueshem tek te tretet, por duke u ofruar me pare mundesine ortakeve te tjere qe te mbesin ne kete shoqeri qe per nje afat prej 60 ditesh te kone mundesi te blejne kuota qe shiten nga ortaku qe largohet nga shoqeria.

VI. DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I "LULI-FARMA" SH.P.K.

NENI 6

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar deklarohet e krijuar ne zbatim te legjislacionit shqiptar si edhe ne zbatim te plote te normave qe permban ky statut. Ajo konfirmerohet e krijuar dhe merr forme te plote juridike me regjistrimin e saj ne regjistrimin tregtar te Gjykatës së Rrethit Tiranë, si dhe merr fuqi per zhvillimin e aktivitetit te saj ekonomik me marrjen e licenses nga zyra e tatimeve te rrethit Tiranë. Ortaket e kesaj shoqerie e drejtojne aktivitetin e punes se saj duke u bazuar ne parimin dhe ne drejten e pronës private.

NENI 7

Emertimi i kesaj shoqerie do te shoqeroje te gjithë dokumentacionin kryesor te nxjerre nga kjo shoqeri si edhe te gjithë dokumentacionin qe ka lidhje me marrëdhëniet e saj me te tretet.

NENI 8

Kjo shoqeri me pergjegjesi te kufizuar do te kete vleren e saj e cila do te kete forme dhe madhesi te pakonshme dhe me tekstin perreth saj, vlera e cila do te shoqeroje te gjithë dokumentacionin e nxjerre nga kjo shoqeri.

NENI 9

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar "LULI-FARMA" vepron ne regjistrimin e pronës shtetërore dhe merr persiper detyrime kontraktore dhe jashte kontraktore. Ortaket e kesaj shoqerie drejtojne te gjithë aktivitetin e saj si edhe te te gjithë detyrimet ndaj te tretëve.

Belqiz Kallaj
Cyru

[Signature]
DREJTUES

NENI 10

Per drejtimin e aktivitetit te saj zgjidhet ASAMBLEA E ORTAKEVE, me ADMINISTRATORET e saj te cilet zgjidhen nga mbledhja e saj. Administratore te pergjithshem do te jene z. Behar Shehu dhe Saimir Tahiri. Asamblea e ortakeve do te jete organ vendimor i kesaj shoqerie. Vendimet e marra nga organi vendimor i kesaj shoqerie, q vijne ne harmoni me dispozitat e ketij statuti dhe me legjislacionin ne fuqi, jane te detyrueshem per te gjitha anetaret e shoqerise.

VI. KOMPETENCAT E ASAMBLESE SE ORTAKEVE

NENI 11.

Asamblea e ortakeve gjate kryerjes se aktivitetit te saj do te kete keto kompetenca:

1. Te miratoje bilancet 3-mujore dhe vjetore, te aktivitetit financiar, ja me vone se nje muaj nga mbylljet kalendarike.
2. Te caktoje rregullin e brendshem te punes.
3. Te caktoje e miratoje merrnin e punonjesve, pagat e tyre si edhe kusht marrjes se tyre ne pune.
4. Te analizoje veprimtarine mujore e vjetore si edhe te percaktoje drejtimin e zgjerimit te aktivitetit.
5. Te miratoje kontratat e nevojshme per zhvillimin e aktivitetit, veprimtarine financiare me persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj.
6. Te percaktoje tarifat e ndertimeve, sherbimeve, riparimeve, transporti, konsulencave etj.
7. Te analizoje dhe miratoje kerkesat per kredi.
8. Te caktoje kriteret dhe te miratoje marrjen me qira te makinerive, automjeteve e mekanizimeve.
9. Te miratoje dhe drejtoje komisionin per likuidimin e shoqerise.
 - Te kryeje detyrat per realizimin e objektivave te shoqerise
 - Te respektojte legjislacionin shqiptar dhe kolin e punes
 - Te shijoje detyrimet financiare ndaj shtetit.

VII. KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT TE PERGJITHSHEM

NENI 12

Administratori i pergjithshem ka keto kompetenca

- percaktimin e drejtimeve kryesore te veprimtarise se shoqerise
- percaktimin e organikes dhe vendeve te punes

Administratori i pergjithshem ka keto kompetenca te tjera:

- te miratoje kontratat e nevojshme per zhvillimin e aktivitetit, veprimtarine financiare me persona fizike dhe juridike vendas dhe te huaj.
- te percaktojte tarifat e ndertimeve, sherbimeve, riparimeve, transporti, konsulencave etj.
- te analizoje dhe miratoje kerkesat per kredi.
- te caktojte kriteret dhe te miratoje marrjen me qira te makinerive, automjeteve e mekanizimeve.
- te miratoje dhe drejtoje komisionin per likuidimin e shoqerise.
- te kryeje detyrat per realizimin e objektivave te shoqerise
- te respektojte legjislacionin shqiptar dhe kolin e punes
- te shijoje detyrimet financiare ndaj shtetit.



Behar Shehu
Saimir Tahiri

Saimir Tahiri



NENI 13

Te gjitha kompetencat e mesiperme do te realizohen ne mirekuptim dhe ne marrev
me ortakun e vetem.

VII. PERFAQESIMI I SHOQERISE

NENI 14.

Administratori i pergjithshem e perfaqeson kete shoqeri ne te gjitha marredhen
me organet shtetere, gjyqesore, financiare e private. Me vendim te Asamblese se or
keve te kesaj shoqerie per veprime te ndryshme si eshe per probleme te veçanta gjate
aktivitetit te kesaj shoqerie me prokure te pergjithshme apo te posaçme caktohet nje
person i cili mund te jete punonjes ose jo ne kete shoqeri per kryerjen e veprimeve
te ndryshme te cilat do te jene te parashikuara ne kete prokure.

VIII. ADMINISTRIMI I TE ARDHURAVE TE REALIZUARA

NENI 15

Per administrimin e te ardhurave gjate aktivitetit te saj do te caktohet nje
revizor i cili do te kryeje te gjitha veprimet financiare te nevojshme per evidentimi
n e te ardhurave te realizuara, fitimit te arditur si edhe detyrimete etj ne lidh
me keto. Te ardhurat do te evidentohen ne librat e llogarise me llogarite e saj te
veçanta, keshtu konkretisht do te behet llogaritja e te ardhurave te pergjithshme i
realizuara, duke u zbritur keshtu tatimi mbi qarkullimin, tatimi, fitimin, te gjith

NENI 16

Kjo shoqeri ka te drejte te punesoje ne shoqerine e saj shtetas shqiptar apo t
huaj. Marrotheniet e saj me te punesuarit ajo i rrugillon me ane te kontratave te p
te cilat mund te jene individuale apo kolektive gjithnje ne zbatim te legjislacioni
shqiptar te punes si edhe te dispozitave ta statutit.

NENI 17

Te gjitha mosmarrveshjet e krijuara nga kjo shoqeri, ne qoftese nuk zgjidhen
me mirekuptim ndermjet paleve pundehenes dhe te punesuar kompetente per zgjidhjen e
tyre do te behet Gjykata e Rrethit Tirane.

X. SEKRETI AFARIST

NENI 18

Do te quhen sekret afarist per kete shoqeri te gjitha dokumentet dhe aktet e
cilesuara si te tilla nga ASAMBLEA E ORTAKJEVE TE kesaj shoqerie. Kete sekret kane
detyrimin ta ruajne te gjitha punonjesit e punesuar ne kete shoqeri.

Prokuror
Çeliku

SH
TIRANE



XI. SHPERNDARJA DHE LIKUJDIMI I SHOQERISE

NENI 19

Kjo shoqeri e ndryshon aktivitetin dhe menyren e organizimit te saj me ane te shperndarjes, e cila mund te shperndahe vetem ne rast se nuk e ushtron aktivitetin e saj ose ne rast te force madhore, po keshtu edhe ne formen e likujdimit. Per likujdimin e saj me vendim te Asamblese se Ortakeve se shoqerise krijohet komisioni i likujdimit te shoqerise, i cili harton bilancin e likujdimit dhe e paraqet ate para Asamblese se Ortakeve. Ne momentin e miratimit te saj (bilanci) Administratoret e pergjithshem shpallin likujdimin e shoqerise. Pas kesaj shpallje kryhen te gjitha veprimet e nevojshme per qregjistrimin e saj nga regjistri i Gjykates se Rrethit Tirane si ne zyre e tatimeve.

NENI 20

Me vendim te Asamblese se Ortakeve te kesaj shoqerie mund te behen ndryshime objektin e ketij statuti, ne pjese marrjon e shoqerise shitesa ne te, te ndryshoje kryeli i saj, kohesgjatja si edhe vendqendrimi i saj.

DISPOZITA TE PERGJITHSHME

Te gjitha ndryshimet qe do te pasqjne ne legjislacionin shqiptar ne lidhje me shoqerine tregtare te krijuara, po te jete e nevojshme do te pasqyrohen edhe ne dispozitat perkatese te ketij statuti.

SHOQERIA NE PERKJEUJESI TE KUPIZUAR
"MULLI-FARMA" SH.P.K.

ORPAMENT

Behar Shehu

Saimir Tahiri

Tirane, me 26.03.1985

TAHIRI

REGJISTRIMI I SHOQERISE
MINISTERIA E DREKTESISE
NOTERIA

Nr. 1023 Rep.
Nr. 259 Kol.

VERTETIM

Sot me 26.03.1985, para meje Noteres se Rrethit Tirane, uparaqiten persone Behar Shehu dhe Saimir Tahiri me leternjoftimin e tyre personal, madhore, me qelqsi te plate juridike per te vepruar te cilet deklaruan se sa me siper eshte sipas vullnetit te tyre te lire te plate dhe e nenskruar para meje rregullisht dhe une Noterja e vertetoj sipas ligjit rregullisht.



NOTERE
NOTERE
NEXHLA KELLEZI

